



Federata Shqiptare e Futbollit

RREGULLORE PËR STATUSIN DHE TRANSFERIMIN E LOJTARËVE

Botim zyrtar, 2019

PËRMBAJTJA

Rregulloret për Statusin dhe Transferimin e Lojtarëve

Përkufizime 7

I. Dispozitat hyrëse

Neni 1 Fusha e zbatimit 10

II. Statusi i lojtarëve

Neni 2 Statusi i lojtarëve: lojtarët amatorë dhe profesionistë 11

Neni 3 Rimarrja e statusit të lojtarit amator 11

Neni 4 Ndërprerja e aktivitetit 12

III. Regjistrimi i lojtarëve

Neni 5 Regjistrimi 12

Neni 6 Periudhat e regjistrimit 13

Neni 7 Pasaporta e lojtarëve 15

Neni 8 Aplikimi për regjistrim 15

Neni 9 Certifikata ndërkombëtare e transferimit .. 15

Neni 10 Huazimi i Profesionistëve	16
Neni 11 Lojtarët e peregjistruar	16
Neni 12 Zbatimi i pezullimeve disiplinore	17
Neni 12/1 Detyrimet e prapambetura	17

IV. Ruajtja e qëndrueshmërisë kontraktuale

mes profesionistëve dhe klubeve

Neni 13 Respektimi i kontratës	19
Neni 14 Ndërprerja e një kontrate me kauzë të drejtë	19
Neni 14/1 Ndërprerja e një kontrate me shkak të ligjshëm për pagat e prapambetura	20
Neni 15 Ndërprerja e një kontrate me shkak të drejtë sportiv	20
Neni 16 Kufizimi i ndërprerjes së kontratës gjatë sezonit	21
Neni 17 Pasojat e ndërprerjes së një kontrate për shkak të ligjshëm	21
Neni 18 Dispozita të veçanta në lidhje kontratat mes profesionistëve dhe klubeve	23

V. Influenca dhe pronësia e palëve të treta për drejtat ekonomike të lojtarëve

Neni 18/1 Influenca e palëve të treta tek klubet	25
--	----

Neni 18/2 Pronësia e palëve të treta të të drejtave ekonomike të lojtarëve	25
---	----

VI. Transferimet ndërkombëtare që përfshijnë të miturit

Neni 19 Mbrojtja e të miturve dhe regjistrimi në akademi	26
---	----

VII. Kompensimi për trajnimin dhe mekanizmi i solidaritetit

Neni 20 Kompensimi për trajnimin	26
--	----

VIII. Juridiksioni

Neni 21 Kompetencat e FSHF	27
Neni 22 Dhoma e zgjidhjes së konflikteve	27
Neni 22/1 Ekzekutimi i vendimeve monetare	28
Neni 23 Udhëzimet procedurale	29

IX. Dispozita përfundimtare

Neni 24 Dispozitat Kalimtare	29
Neni 25 Çështjet që nuk parashikohen	32
Neni 26 Hyrja në fuqi, Gjuhët zyrtare	30
Neni 27 Zbatimi	30

Shtojca 1:

Kthimi i lojtarëve tek ekipet kombëtare 31

Shtojca 2:

Kompensimi për trajnimin32

Për qëllim të këtyre rregulloreve, termat e përmendura përkufizohen si më poshtë:

1. **Federata e mëparshme:** federata në të cilën klubi i mëparshëm është i lidhur.
2. **Ish klubi:** klubi nga i cili po largohet lojtari.
3. **Federata e re:** federata ku është bërë anëtar klubi i ri.
4. **Klubi i ri:** klubi i cili lojtari po bashkohet.
5. **Ndeshje zyrtare:** ndeshje të luajtura brenda kuadrit të futbollit të organizuar prej FSHF.
6. **Futboll i organizuar:** çdo aktivitet futbollit i organizuar prej FSHF ose një federatë futbollit e organizuar nën mbikëqyrjen e FIFA-s.
7. **Periudhë e mbrojtur:** një periudhë prej tre sezonesh ose tre vite të plota, cilado të vijë e para, pas hyrjes në fuqi të kontratës, ku kjo kontratë do të mbyllet para ditëlindjes së 28 të profesionistit, ose dy sezone ose dy vite të plota, cilado të vijë e para, pas hyrjes në fuqi të kontratës, ku kjo kontratë do të mbyllet pas ditëlindjes së 28 të profesionistit.
8. **Periudha e regjistrimit:** një periudhë e përcaktuar nga FSHF në përputhje me neni 6.

9. **Sezoni:** periudha e cila fillon me ndeshjen e pare zyrtare të kampionatit të ligës së kombeve përkatëse dhe përfundon me ndeshjen e fundit zyrtare të kampionatit të ligës së kombeve përkatëse.
10. **Kompensimi për trajnimin:** pagesat e kryera në përputhje me Shtojcën 2 për të mbuluar shpenzimet e lojtarëve të rinj.
11. **Minoren:** një lojtar i cili nuk ka mbushur moshën 18 vjeç.
12. **Akademi:** një organizatë ose një person juridik i pavarur, qëllimi kryesor dhe afatgjatë i të cilit është që të ofrojë lojtarë me stërvitje afatgjatë nëpërmjet ofrimit të ambienteve dhe infrastrukturës së nevojshme për stërvitje. Kjo përfshin së pari, por jo vetëm, qendrat stërvitore të futbollit, kampet e futbollit, shkollat e futbollit, etj.
13. **Sistemi i Transferimeve (TMS):** një sistem për informacione të dhënash i bazuar në internet, objektivi parësori i së cilës është të thjeshtojë procesin e transferimit të lojtarëve në rang ndërkombëtar si dhe të përmirësojë transparencën e qarkullimit të informacionit.
14. **Palë e tretë:** një palë tjetër përveç dy klubeve që transferon një lojtar nga një klub në tjetrin, apo ndonjë klub i mëparshëm, me të cilin lojtari është regjistruar.

15. **Futbolli me njëmbëdhjetë lojtarë:** futbolli që luhet në përputhje me ligjet e lojës siç miratohet nga IFAB.
16. **Futsal:** futbolli që luhet në përputhje me Ligjet e Futsalit të Lojërave të hartuara nga FIFA në bashkëpunim me IFAB.

Gjithashtu, duhet të bëhet referencë edhe me seksionin e Përkufizimeve në Statutet e FIFA-s dhe FSHF-së.

NB: Termat të cilat i referohen personit fizik janë të zbatueshme për të dyja gjinitë. Çdo term në njëjës zbatohet edhe në shumës dhe anasjelltas.

NENI 1

FUSHA E ZBATIMIT

1. Këto rregullore përcaktojnë rregullat e përgjithshme dhe detyruese në lidhje me statusin e lojtarëve, të drejtën për të marrë pjesë në futbollin e organizuar, dhe transferimet e tyre midis klubeve anëtare të FSHF
2. Transferimi i lojtarëve ndërmjet klubeve që i përkasin federatave të ndryshme rregullohet nga rregulloret specifike të lëshuara FIFA.
3. Klubet apo shoqatat të cilat janë anëtare të FSHF ose marrin pjesë në aktivitetet e organizuara prej saj, duhet të marrin masa të përshtatshme për të mbrojtur qëndrueshmërinë kontraktuale, duke i kushtuar vëmendjen e duhur respektimit të ligjeve të detyrueshme kombëtare dhe marrëveshjeve të negocimit kolektive. Në veçanti, duhet të konsiderohen parimet e mëposhtme:
 - neni 13: parimi që kontratat duhet të respektohen;
 - neni 14: parimi që kontrata mund të ndërpritet nga secila palë pa pasoja kur ka shkak të ligjshëm;
 - neni 15: parimi që kontratat mund të ndërpritin nga profesionistët për shkak të ligjshëm
 - neni 16: parimi që kontratat nuk mund të ndërpritin gjatë periudhës së sezonit;
 - neni 17 paragrafi 1 dhe 2: parimi që në rastin e ndërprerjes së kontratës pa asnjë shkak të

- ligjshëm, duhet paguar një kompensim dhe ky kompensim mund të përcaktohet në kontratë;
- neni 17, paragrafët 3-5: parimi që në përfundim të ndërprerjes së kontratës pa shkak të ligjshëm apo kauzë të drejtë, sanksione sportive do të vendosen për palën shkelëse.

NENI 2

STATUSI I LOJTARËVE: LOJTARËT AMATORË DHE PROFESIONISTË

1. Lojtarët pjesëmarrës në futbollin e organizuar janë lojtarë amatorë ose profesionistë.
2. Profesionist quhet një lojtar i cili ka nënshkruar një kontratë me një klub dhe paguhet më shumë për aktivitetet e tij në futboll se sa për shpenzimet të cilat ka. Të gjithë lojtarët e tjerë konsiderohen si amatorë.

NENI 3

RIMARRJA E STATUSIT TË LOJTARIT AMATOR

1. Një lojtar i regjistruar si profesionist nuk mund të regjistrohet përsëri si amator të paktën deri në 30 ditë pas ndeshjes së tij të fundit si profesionist.
2. Asnjë kompensim nuk paguhet pas rimarrjes së statusit amator. Nëse një lojtar regjistrohet përsëri

si profesionist brenda 30 muajve nga riemërimi si amator, klubi i ri paguan kompensimin për trajnimin në përputhje me nenin 20.

NENI 4

NDËRPRERJA E AKTIVITETIT

1. Profesionistët të cilët e përfundojnë karrierën pas skadimit të kontratës dhe amatorët të cilët përfundojnë aktivitetin e tyre do jenë të regjistruar në federatën e klubit të fundit për një periudhë prej 30 muajsh.
2. Kjo periudhë fillon me ditën kur lojtari shfaqet për herë të fundit në një ndeshje zyrtare për klubin.

NENI 5

REGJISTRIMI

1. Një lojtar duhet të jetë i regjistruar në FSHF ose në një federatë anëtare të FIFA-s, për të luajtur në një klub qoftë si profesionist apo amator në përputhje me dispozitat e nenit 2. Vetëm lojtarët e regjistruar kanë të drejtë për të marrë pjesë në futbollin e organizuar. Me aktin e regjistrimit, lojtari bie dakord t'i përmbahet statuteve dhe rregulloreve të FSHF-së dhe FIFA-s.
2. Një lojtar mund të jetë i regjistruar vetëm në një klub në një periudhë të caktuar kohe.

3. Lojtarët mund të regjistrohen maksimalisht në tre klube gjatë një sezoni.

Gjatë kësaj periudhe, lojtari ka të drejtë që të luajë ndeshje zyrtare vetëm në dy klube. Si përjashtim nga ky rregull, një lojtar i cili lëviz midis dy klubeve të cilat i përkasin federatave të cilat kanë sezonin në të njëjtën kohë (psh fillimi i sezonit është në verë/vjeshtë në kundërshtim me dimër/pranverë) kanë të drejtën për të luajtur në ndeshje zyrtare për një klub të tretë gjatë sezonit përkatës, duke siguruar se ka përmbushur detyrimet kontraktuale me klubin e mëparshëm. Njësoj, dispozitat e lidhura me periudhat e regjistrimit (neni 6) si edhe kohëzgjatja minimale e kontratës (neni 18, paragrafi 2) duhet të respektohen.

4. Në të gjitha rrethanat, duhet t'i kushtohet vëmendje e duhur integritetit sportiv të konkurrencës. Në veçanti, një lojtar nuk mund të luajë ndeshje zyrtare për më shumë se dy klube të cilat konkurrojnë në të njëjtin kampionat apo kupë kombëtare gjatë të njëjtit sezon, duke iu nënshtruar rregullave më të rrepta të konkurrencës individuale të federatave anëtare.

NENI 6

PERIUDHAT E REGJISTRIMIT

1. Lojtarët mund të regjistrohen gjatë njëjës prej dy periudhave të regjistrimit të caktuara nga FSHF. FSHF mund të përcaktojë periudha të ndryshme regjistrimi

për garat e meshkujve dhe femrave. Si përjashtim nga ky rregull, një profesionist kontrata e të cilit ka skaduar para fundit të periudhës së regjistrimit mund të regjistrohet jashtë periudhës së regjistrimit. FSHF mund të regjistrojë këto profesionistë me kusht që t'i kushtohet vëmendje integritetit sportiv të ndeshjeve përkatëse. Kur një kontratë ndërpritet për shkak të ligjshëm, FSHF mund të marrë masa të përkohshme, në mënyrë që të shmangë abuzimet, në përputhje me nenin 22.

2. Periudha e parë e regjistrimit fillon pas përfundimit të sezonit dhe përfundon normalisht para fillimit të sezonit të ri. Kjo periudhë nuk duhet të zgjasë më shumë se dymbëdhjetë javë. Periudha e dytë e regjistrimit fillon në mes të sezonit dhe nuk mund të zgjasë më shumë se katër javë.
3. Lojtarët mund të regjistrohen (duke iu nënshtruar përjashtimit të parashikuar në nenin 6 paragrafi 1) duke paraqitur një aplikimi të vlefshëm nga klubi tek FSHF gjatë një periudhe regjistrimi.
4. Dispozitat në lidhje me periudhat e regjistrimit nuk zbatohen për garat ku marrin pjesë vetëm amatorë. FSHF përcakton periudhat kur lojtarët mund të regjistrohen për gara të tilla me kusht që të merren parasysh si duhet integriteti sportiv i garave përkatëse.

NENI 7

PASAPORTA E LOJTARËVE

1. FSHF është e detyruar të sigurojë klubin me të cilin lojtari është i regjistruar me një pasaportë të lojtarit që përmban detajet përkatëse të lojtarit. Pasaporta e lojtarit tregon klubet me të cilat lojtari ka qenë i regjistruar që nga sezoni i ditëlindjes së tij të 12-të. Nëse ditëlindja bie në mes të sezoneve, pasaporta e lojtarit tregon klubin me të cilin është regjistruar gjatë sezonit pas ditëlindjes.

NENI 8

APLIKIMI PËR REGJISTRIM

1. Aplikimi për regjistrimin e një profesionisti do të dorëzohet bashkë me një kopje të kontratës së lojtarit. FSHF ka liri veprimi për të marrë parasysh çdo ndryshim kontraktuar ose marrëveshje shtesë që nuk është dorëzuar siç duhet.

NENI 9

CERTIFIKATA E TRANSFERIMIT NDËRKOMBËTAR

1. Lojtarët e regjistruar në një federatë mund të regjistrohen në një federatë të re vetëm pasi kjo e fundit të ketë marrë një Certifikatë Ndërkombëtare

Transferimi (në vijim referuar si: CNT) nga federata e mëparshme konform rregullave të FIFA-s.

NENI 10

HUAZIMI I PROFESIONISTËVE

1. Një profesionist mund të huazohet në një klub tjetër në bazë të një marrëveshjeje me shkrim ndërmjet tij dhe klubeve përkatëse. Çdo huazim i tillë i nënshtrohet të njëjtave rregullave si te transferimi i lojtarëve.
2. Sipas nenit 5 paragrafi 3, periudha minimale e huazimit është koha midis dy periudhave të regjistrimit.
3. Klubi që pranon lojtarin në huazim nuk është i autorizuar për ta transferuar atë në një klub të tretë pa miratimin me shkrim të klubit që e ka huazuar dhe vetë lojtarit.

NENI 11

LOJTARËT E PAREGJISTRUAR

1. Çdo lojtar i pa regjistruar, që aktivizohet për një klub në ndeshje zyrtare konsiderohet të ketë luajtur në mënyrë të pa rregullt. Me verifikimin e këtyre rasteve, e drejta për të vendosur sanksione i takon Komisionit të Disiplinës.

NENI 12

ZBATIMI I MASAVE DISIPLINORE

1. Çdo sanksion disiplinor që është vendosur ndaj një lojtari përpara transferimit por që nuk është shlyer ende plotësisht, do të mbartet në klubin ku lojtari transferohet. Klubi i mëparshëm është i detyruar të njoftojë klubin e ri për çdo dënim disiplinor me shkrim.

NENI 12/1

DETYRIMET E PRAPAMBETURA

1. Klubet janë të detyruara të përmbushin detyrimet e tyre financiare ndaj lojtarëve dhe klubeve të tjera sipas kushteve të përcaktuara në kontratat e nënshkruara me lojtarët e tyre profesionistë dhe në marrëveshjet e transferimit.
2. Çdo klub që zbulohet se ka vonuar pagesat e detyruara për një periudhë më të gjatë se 30 ditë pa shkak të ligjshëm kontraktual në *prima facie* mund të sanksionohet në përputhje me paragrafin 4 më poshtë.
3. Në mënyrë që një klub të konsiderohet se ka detyrime të prapambetura në kuptim të këtij neni, kreditori (lojtari ose klubi) duhet ta njoftojë me shkrim për mospërmbushjen dhe t'i caktojë një afat prej të paktën dhjetë ditësh për të përmbushur detyrimet e tij financiare.

4. Brenda fushës së zbatimit të juridiksionit të tyre përkatës, Dhoma e Zgjidhjes së Konfliktëve mund të vendosë sanksionet e mëposhtme:
 - a) paralajmërim;
 - b) qortim;
 - c) gjobë;
 - d) ndalim nga regjistrimi i lojtarëve të rinj, qoftë në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, për një ose dy periudha regjistrimi të plota dhe të njëpasnjëshme.
5. Sanksionet e parashikuara në paragrafin 4 më sipër mund të aplikohen të kombinuara.
6. Një shkelje e përsëritur do të konsiderohet si rrethanë rënduese dhe do të çojë në dhënien e një dënimi më të rëndë.
7. Zbatimi i ndalimit të regjistrimit në përputhje me paragrafin 4 d) më sipër mund të pezullohet. Duke pezulluar zbatimin e ndalimit të regjistrimit, organi vendimmarrës e bën klubin e sanksionuar subjekt të një periudhe prove që varion nga 6 (gjashtë) muaj deri në dy vite
8. Nëse klubi që përfiton nga pezullimi i ndalimit të regjistrimit, kryen një tjetër shkelje gjatë periudhës së provës, pezullimi hiqet automatikisht dhe ekzekutohet ndalimi i regjistrimit; dhe shtohet sanksioni i vendosur për shkeljen e re.

9. Termat e këtij neni nuk cenojnë zbatimin e masave të mëtejshme në përputhje me nenin 17, në rast të ndërprerjes së njëanshme të marrëdhënieve kontraktuale.

NENI 13

RESPEKTIMI I KONTRATËS

1. Një kontratë midis një profesionisti dhe një klubi mund të ndërpritet vetëm pas skadimit të afatit të kontratës ose me marrëveshje të përbashkët.

NENI 14

NDËRPRERJA E KONTRATËS ME SHKAK TË LIGJSHËM

1. Një kontratë mund të ndërpritet nga secila palë pa asnjë lloj pasojë (pagesa e kompensimit apo vendosja e sanksioneve sportive) kur ka një shkak të ligjshëm.
2. Çdo sjellje abuzive e një pale që synon të detyrojë palën tjetër të ndërpresë ose të ndryshojë kushtet e kontratës, i jep të drejtën palës tjetër (një lojtari ose një klubi) ta ndërpresë kontratën me shkak të ligjshëm.

NENI 14/1

NDËRPRERJA KONTRATËS ME SHKAK TË LIGJSHËM PËR PAGAT E PRAPAMBETURA

1. Në rastet kur një klub, në mënyrë të paligjshme nuk i paguan një lojtari të paktën dy muaj pagese në afatin e caktuar, lojtari konsiderohet të ketë një shkak të ligjshëm për të ndërprerë kontratën, me kusht që ai të ketë njoftuar me shkrim klubin debitor dhe të ketë dhënë një afat prej të paktën 15 ditës që klubi debitor të përmbushë detyrimet financiare.
2. Për çdo pagë të lojtarëve që nuk paguhet në bazë mujore, merret parasysh vlera proporcionale që korrespondon me dy muaj. Pagesa e vonuar e shumës e cila është e barabartë me të paktën dy muaj konsiderohet si kauzë e drejtë që lojtari të ndërpresë kontratën e tij, duke e bërë atë ti nënshtrohet pajtueshmërisë me njoftimin e ndërprerjes sipas paragrafit 1 më lart.

NENI 15

NDËRPRERJA E NJË KONTRATE ME SHKAK TË DREJTË SPORTIV

1. Një profesionist i regjistruar, i cili gjatë sezonit është aktivizuar në më pak se dhjetë për qind të ndeshjeve zyrtare në të cilat klubi i tij ka luajtur, mund të përfundojë kontratën e tij para kohe për shkak të drejtë sportiv. Vëmendje e posaçme i

duhet kushtuar rrethanave të lojtarit në vlerësimin e rasteve të tilla. Ekzistenca e një shkakut të drejtë sportiv do të vlerësohet saktë rast pas rasti. Në raste të tilla, sanksionet sportive nuk aplikohen, edhe pse kompensimi mund të paguhet. Një profesionist mund të përfundojë kontratën e tij 15 ditë pas ndeshjes së tij të fundit zyrtare të sezonit të klubit me të cilin ai është i regjistruar.

NENI 16

KUFIZIMI I NDËRPRERJES SË KONTRATËS GJATË SEZONIT

1. Një kontratë nuk mund të ndërpritet në mënyrë të njëanshme gjatë një sezoni.

NENI 17

PASOJAT E NDËRPRERJES SË NJË KONTRATE PËR SHKAK TË LIGJSHËM

Dispozitat e mëposhtme janë të vlefshme në rastet kur kontrata ndërpritet pa shkak të ligjshëm:

1. Në të gjitha rastet, pala shkelëse paguan kompensim. Në bazë të dispozitave të nenit 20 dhe Shtojcës 2 në lidhje me kompensimin për trajnimin, dhe nëse nuk parashikohet ndryshe në kontratë, kompensimi për këtë shkelje llogaritet duke marrë parasysh legjislacionin në fuqi, specifikat e sportit dhe çdo kriter

tjetër objektiv. Këto kritere përfshijnë, në veçanti, shpërblimet dhe përfitimet e tjera që i takojnë lojtarit sipas kontratës ekzistuese dhe / ose kontratës së re, kohën e mbetur në kontratën ekzistuese deri në maksimumi pesë vjet etj.

2. E drejta e kompensimit nuk mund ti caktohet një pale të tretë. Nëse një profesionisti i kërkohet të paguajë kompensimin, ky profesionist dhe klubi i tij i ri do të jenë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për pagesën e tij. Shuma mund të përcaktohet në kontratë ose palët mund të bien vetë dakord.
3. Përveç detyrimit për të paguar kompensimin, mund të përcaktohen gjithashtu sanksione sportive për çdo lojtar i cili ka shkelur kontratën gjatë periudhës së mbrojtur. Ky sanksion do të jetë një kufizim dy-mujor për të luajtur në ndeshjet zyrtare. Në rastet e rrethanave rënduese, kufizimi mund të zgjatet katër muaj. Këto sanksione sportive hyjnë në fuqi menjëherë sapo lojtari të jetë njoftuar për vendimin përkatës. Sanksionet sportive mbeten të pezulluara në periudhën midis ndeshjes së fundit zyrtare të sezonit dhe ndeshjes së parë zyrtare të sezonit të ardhshëm, në të dy rastet, duke përfshirë kupat kombëtare dhe kampionatet ndërkombëtare për klubet.
4. Përveç detyrimit për të paguar kompensimin, do të përcaktohen gjithashtu sanksione sportive për çdo klub i cili shkel kontratën ose vërtetohet se ka shkaktuar një shkelje të kontratës gjatë periudhës së mbrojtur. Supozohet, përveç rasteve kur është

e vërtetuar ndryshe, që çdo klub që ka nënshkruar me një profesionist i cili e ka ndërprerë kontratën e tij pa shkak të ligjshëm, ka nxitur atë profesionist të kryejë këtë shkelje. Klubi do të ndalohej të regjistrojë lojtarë të rinj, qoftë kombëtar apo ndërkombëtar, për dy periudha regjistrimi. Klubi është në gjendje të regjistrojë lojtarë të rinj, si në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, vetëm nga periudha e ardhshme e regjistrimit pas shlyerjes së plotë të sanksionit përkatës sportiv. Në veçanti, nuk mund të përdorë përjashtimet dhe masat e përkohshme të përcaktuara në nenin 6 paragrafi 1 të këtyre rregulloreve, në mënyrë që të regjistrojë lojtarë në një fazë më të hershme.

5. Çdo person që i nënshtrohet Statutit dhe rregulloreve të FSHF-së të cilët veprojnë në një mënyrë të caktuar për të shkaktuar një shkelje të kontratës ndërmjet një profesionisti dhe një klubi në mënyrë që të lehtësojë transferimin e lojtarit do të jetë objekt sanksionesh.

NENI 18

DISPOZITA TË VEÇANTA NË LIDHJE ME KONTRATAT MES PROFESIONISTËVE DHE KLUBEVE

1. Nëse një ndërmjetës përfshihet në një kontratë, emri i tij vendoset në kontratë.
2. Kohëzgjatja minimale e një kontrate duhet të jetë nga

dita e hyrjes në fuqi deri në fund të sezonit, ndërsa kohëzgjatja maksimale e një kontrate do të jetë pesë vite.

Lojtarët nën moshën 18 vjeç nuk mund të firmosin një kontratë profesionale më të gjatë se tre vite. Çdo nen që i referohet një periudhe më të gjatë nuk do të njihet

- 3.** Një klub i cili synon të lidhë kontratë me një profesionist duhet të informojë klubin aktual të lojtarit me shkrim para se të futet në negociata me të. Një profesionist do të jetë i lirë të përmbyllë kontratën me një klub tjetër nëse kontrata me klubin e tij aktual ka përfunduar ose përfundon për gjashtë muaj. Çdo shkelje e kësaj dispozite do të nënshtrohet sanksioneve.
- 4.** Vlefshmëria e një kontrate nuk mund t'i nënshtrohet ekzaminimit të suksesshëm mjekësor dhe/ose dhënies së lejes së punës.
- 5.** Nëse profesionisti nënshkruan më shumë se një kontratë gjatë së njëjtës periudhë, do të zbatohen dispozitat e përcaktuara në Kapitullin IV.
- 6.** Klauzolat kontraktuale që i japin klubit kohë shtesë për të paguar shumat profesionale që janë maturuar sipas kushteve të kontratës (të ashtuquajturat “periudhat falas”) nuk do të njihen. Kontratat ekzistuese në momentin kur kjo dispozitë hyn në fuqi nuk preken nga kjo dispozitë.

NENI 18/1

INFLUENCA E PALËVE TË TRETA TE KLUBET

1. Asnjë anëtar i FSHF-së apo klub që merr pjesë në aktivitetet e organizuara prej saj, nuk duhet të nënshkruajë një kontratë që mundëson një palë tjetër të asaj kontrate ose ndonjë pale të tretë që të ndikojë në çështjet e punësimit dhe transferimit të lojtarëve, pavarësinë, politikat e saj ose performancën e ekipeve të saj.
2. Komisioni i Disiplinës mund të vendosë masa disiplinore ndaj klubeve që nuk respektojnë detyrimet e përcaktuara në këtë nen.

NENI 18/2

PRONËSIA E PALËVE TË TRETA TË TË DREJTAVE EKONOMIKE TË LOJTARËVE

1. Asnjë klub ose lojtar nuk do të hyjë në marrëveshje me një palë të tretë me anë të së cilës t'i shes apo delegojë, plotësisht ose pjesërisht, në kompensimin e pagueshëm në lidhje me transferimin e ardhshëm të një lojtari nga një klub në një tjetër ose duke marrë ndonjë të drejtë në lidhje me një transferim të ardhshëm ose kompensim për transferimin.
2. Komisioni i Disiplinës mund të vendosë masa disiplinore ndaj klubeve që nuk respektojnë detyrimet e përcaktuara në këtë nen.

NENI 19

MBROJTJA E TË MITURVE DHE REGJISTRIMI NE AKADEMI

- 1.** Transferimet e lojtarëve lejohen vetëm nëse lojtari është më shumë se 18 vjeç.
- 2.** Klubet që kanë akademi, janë të detyruar të raportojnë në FSHF të gjithë të miturit që trajnohen/aktivizohen në to.
- 3.** FSHF është e detyruar të sigurohet që të gjitha akademitë që përmbushin kriteret e licencimit, të marrin pjesë në kompeticionet përkatëse duke mbajtur evidencat përkatëse
- 4.** Përmes pjesëmarrjes në kompeticione, akademitë marrin përsipër tu nënshtrohen statutit dhe rregulloreve të FSHF duke respektuar parimet etike të futbollit.
- 5.** Çdo shkelje e këtyre parashikimeve do të jetë subjekt i vendimmarrjes së Komisionit të Disiplinës.

NENI 20

KOMPENSIMI PËR TRAJNIMIN

Kompensimi për trajnimin i paguhet klubit (klubeve) që ka trajnuar lojtarin kur lojtari nënshkruan kontratën e

parë si profesionist. Dispozitat në lidhje me kompensimin për trajnimin përcaktohen në Shtojcën 2 të kësaj rregulloreje. Parimet e kompensimit për trajnimin nuk zbatohen për futbollin për femra.

NENI 21

KOMPETENCAT E FSHF-SË

Pa cenuar të drejtat civile të lojtarëve ose klubeve, FSHF ka kompetenca për të gjykuar:

- a) mosmarrëveshjet midis klubeve dhe lojtarëve apo trajnerëve në lidhje me ruajtjen e qëndrueshmërisë kontraktuale;
- b) mosmarrëveshjet e lidhura me kompensimin për trajnimin midis anëtarëve të FSHF apo klubeve që marrin pjesë në aktivitetet e organizuara prej saj;

NENI 22

DHOMA E ZGJIDHJES SË KONFLIKTEVE

1. Dhoma Kombëtare e Zgjidhjes së Konfliktëve (DHKZK) gjykon secilin nga rastet e përshkruara në nenin 21.
2. DHKZK gjykon në prani të tre anëtarëve, duke përfshirë kryetarin ose zëvendës kryetarin, përveç se kur rasti është i një natyre të tillë që mund të zgjidhet nga një gjyqtar i vetëm.

NENI 22/1

EKZEKUTIMI I VENDIMEVE MONETARE

1. Kur udhëzohet një palë (klub ose lojtar) për ti paguar një shumë parash (shuma të papaguara ose kompensim) një pale tjetër (klub ose lojtar), DHKZK-ja, shprehet edhe për pasojat e mospagimit të shumave të papaguara në fjalë në kohën e duhur.

2. Këto pasoja duhet të përfshihen në dispozitivin e vendimit dhe do të jenë si më poshtë:

Për një klub, ndalimi nga regjistrimi i lojtarëve të rinj, si në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, derisa të paguhen shumat e papaguara. Kohëzgjatja maksimale e përgjithshme e ndalimit të regjistrimit, duke përfshirë edhe sanksionet e mundshme sportive, është tre periudha të plota dhe të njëpasnjëshme regjistrimi;

Për një lojtar, një ndalim për të luajtur në ndeshje zyrtare derisa të paguhen shumat e papaguara. Kohëzgjatja maksimale e përgjithshme e ndalimit, duke përfshirë edhe sanksionet e mundshme sportive, është gjashtë muaj aktivizim në ndeshjet zyrtare.

3. Ndalimi i regjistrimit ose i aktivizimit do të hiqet para shlyerjes së plotë, sapo të paguhen shumat e papaguara.

4. Ndalimi i regjistrimit ose i aktivizimit zbatohet nëse shumat e papaguara nuk paguhen brenda një afati prej 45 ditësh pasi kreditori i ka dhënë debitorit të

dhënat e kërkuara bankare për pagesën, ndërsa vendimi përkatës është bërë i formës së prerë dhe detyrues.

NENI 23

UDHËZIMET PROCEDURALE

1. Procedurat e hollësishme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të ngritura nga zbatimi i këtyre rregulloreve do të përcaktohen në Rregulloren Dhomës së Zgjidhjes së Konfliktëve miratuar nga Komiteti Ekzekutiv i FSHF-së.

NENI 24

DISPOZITAT KALIMTARE

1. Çdo çështje që është paraqitur pranë FSHF-së përpara hyrjes në fuqi të këtyre rregulloreve vlerësohet sipas rregullave të mëparshme.
2. Si rregull i përgjithshëm, të gjitha rastet e tjera do të vlerësohen sipas kësaj rregulloreje. Çdo rast që nuk i nënshtrohet këtij rregulli të përgjithshëm vlerësohet sipas rregulloreve që ishin në fuqi kur u nënshkrua kontrata gjatë mosmarrëveshjes ose kur u ngritën faktet e mosmarrëveshjet.

NENI 25

ÇËSHJET QË NUK JANË PARASHIKUAR

Çështjet që nuk janë të parashikuara në këtë rregullore dhe çështjet e *forcave madhore* vendosen nga Komiteti Ekzekutiv i FSHF, vendimet e të cilit janë të formës së prerë.

NENI 26

HYRJA NË FUQI GJUHËT ZYRTARE

Kjo rregullore u miratua nga Asambleja e Përgjithshme e FSHF-së më 15 Prill 2019, dhe hynë në fuqi më 1 Qershor 2019.

Për Asamblenë e Përgjithshme të FSHF

President:
Armand Duka

Sekretar i përgjithshëm:
Ilir Shulku

SHTOJCA 1.

KTHIMI I LOJTARËVE TEK EKIPET KOMBËTARE

1. Parimet

Anëtarët e FSHF dhe Klubet që marrin pjesë në aktivitetet e organizuara prej saj, janë të detyruara të lejojnë lojtarët e regjistruar të marrin pjesë në ekipet përfaqësuese të vendit për të cilin lojtari ka të drejtën të luajë në bazë të shtetësisë nëse thirren nga federatat përkatëse. Ndalohet çdo marrëveshje mes lojtarit dhe një klubi që dëshmon të kundërtën.

2. Lejimi i lojtarëve bëhet sipas kushteve të Rregullores së Statusit dhe Transferimit të Lojtarëve të FIFA-s

SHTOJCA 2.

KOMPENSIMI PËR TRAJNIMIN

1. OBJEKTIVI

1. Trajnimi dhe edukimi i lojtarit kryhet midis moshës 12 dhe 23 vjeç.

Kompensimi për trajnimin është i pagueshëm, si rregull i përgjithshëm, deri në moshën 23 vjeçare për trajnimin e kryer deri në moshën 21 vjeçare, përveç nëse është e qartë që një lojtar ka ndërprerë kohën e tij të trajnimit para moshës 21 vjeçare. Në rastin e dytë, kompensimi i trajnimeve është i pagueshëm deri në fund të sezonit në të cilin lojtari arrin moshën 23 vjeçare, por llogaritja e shumës së pagueshme bazohet në vitet midis moshës 12 dhe moshës kur është vërtetohet se lojtari ka përfunduar faktikisht trajnimin e tij.

2. Detyrimi për të paguar kompensimin e trajnimit nuk cenon ndonjë detyrim për të paguar kompensimin për prishje të kontratës.

2. PAGESA E KOMPENSIMIT PËR TRAJNIMIN

1. Kompensimi për trajnimin duhet të paguhet kur një lojtar regjistrohet për herë të parë si lojtar profesionist me një klub anëtar të FSHF ose që merr pjesë në aktivitetet e organizuara prej sajë.

2. Kompensimi për trajnimin nuk duhet të paguhet kur:

- i. klubi i mëparshëm prish kontratën e lojtarit pa shkak të ligjshëm (pa cenuar të drejtat e klubeve të mëparshme);
- ii. lojtari transferohet në një klub të kategorisë së 4-të; ose
- iii. një lojtar profesionist rimerr statusin amator gjatë transferimit.

3. Përgjegjësia për të paguar kompensimin për trajnimin

1. Kur regjistron një profesionist për herë të parë, klubi me të cilin është regjistruar lojtari, është përgjegjës për të paguar kompensimin për trajnimin brenda 30 ditësh nga regjistrimi të gjitha klubeve me të cilat lojtari ka qenë i regjistruar më parë (në përputhje me historikun e karrierës së lojtarit siç pasqyrohet tek pasaporta e lojtarit) dhe që kanë kontribuar në trajnimin e tij duke filluar nga sezoni i ditëlindjes së tij të 12-të. Shuma e pagueshme llogaritet në mënyrë proporcionale sipas periudhës së trajnimit që lojtari ka shpenzuar me secilin klub.
2. Afati për pagesën e kompensimit për trajnimin është 30 ditë pas regjistrimit të lojtarit profesionist me klubin e ri.

4. Kostot e trajnimit

- 1.** Për të llogaritur kompensimin e duhur për shpenzimet e trajnimit dhe edukimit, FSHF i ndanë klubet në katër kategori në përputhje me investimet financiare të klubeve në trajnimin e lojtarëve. Kostot e trajnimit përcaktohen për secilën kategori dhe korrespondojnë me shumën e nevojshme për të trajnuar një lojtar për një vit të shumëzuar me një mesatare të “faktorit të lojtarëve”, që është raporti i lojtarëve që duhet të trajnohen për të prodhuar një lojtar profesionist
- 2.** Kategorizimi i klubeve bëhet nga Komiteti Ekzekutiv dhe publikohet në faqen e internetit të FSHF.

